




2. Matja dhe analizimi i mospërputhjes së aftësive në tregun e punës

Kampusi i Mësimit Online të CEF

Anneleen Vandeplas
ECFIN B2 – Ekonomia e reformave strukturore dhe investimeve


Konteksti

- Mospërputhja e aftësive «**temë e nxehtë**» pas krizës së vitit 2009
 - Lëvizje në të djathtë në lakoren Beveridge
 - Mungesa e aftësive (p.sh. në sektorin e TI-së) dhe mungesa e fuqisë punëtore
 - «Kualifikimi i tepruar»
- Nevoja për të sjellë **qartësi në debat**, veçanërisht për analizën në shkallë vendi për Semestrin Evropian
- Të dhënat e krahasueshme ndërmjet vendeve lejojnë performancë **referuese**




Burimi: Drafti i Raportit të Përbashkët të KE-së mbi Punësimin 2021

Mospërputhja e aftësive makro-ekonomike



Përkufizimi: Shpërndarja relative e vlerësuar (ponderuar) e niveleve të punësimit në grupet e aftësive (me kualifikim të ulët, të mesëm, të lartë) (bazuar në të dhënat e ESTAT AFP)


Mungesa e aftësive në sektorin e industrisë



Përkufizimi: Përqindja e punëdhënësve që tregojnë se fuqia punëtore është faktor kryesor që kufizon prodhimin e tyre. Burimi: Të dhënat e BE-BCS

Mospërputhja në punë: nën-kualifikimi

Nën-kualifikimi (% e të punësuarve)



Përkufizimi: Përqindja e të punësuarve që punojnë në vende pune që kërkojnë kualifikime më të larta se sa që kanë ata. Bazuar në metodologjinë e ILO (2007) dhe të dhënat e ESTAT AFP.

Mospërputhja në punë: mbi-kualifikimi


Mbi-kualifikimi (% e të punësuarve)



Përkufizimi: Përqindja e të punësuarve që punojnë në vende pune që kërkojnë kualifikime më të ulëta se sa që kanë ata. Bazuar në metodologjinë e ILO (2007) dhe të dhënat e ESTAT AFP.

A është duke u rritur mospërputhjet me kalimin e kohës në EU27?

Mospërputhja makro-ekonomike është në rënie




Mungesa e aftësive është duke u rritur



... por i ndikuar nga cikli

Ndikimi i pandemisë Covid në mospërputhjen e aftësive



Ndikimi i pandemisë Covid në punësim (në persona)

- **Personat me kualifikim të lartë** përgjithësisht të mbrojtur më mirë nga pandemia
 - Më shumë gjasa të jenë në gjendje të punojnë nga shtëpia
 - Më pak gjasa të punojnë në vende punë me kontakte intensive
- Ata që veç kanë qenë **më të cenueshëm** para krizës kanë **pësuar më shumë** si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë shëndetësor

**A E PENGON RRITJA E MOSPËRPUTHJES
SË AFTËSIVE RRITJEN E
PRODUKTIVITETIT?**

Qasja empirike



- **Modeli në formë të reduktuar**: produktiviteti i punës është një funksion i kapitalit njerëzor H , mospërputhjes së aftësive S dhe faktorëve ciklik (hendeku i rezultatit (output)) X :

$$LP_{i,t} = c_i + \beta H_{i,t} + \gamma S_{Hi,t} + \delta X_{i,t} + \varepsilon_{i,t}$$

- **Vlerësimi**: efektet fikse të panelit dhe efektet e rastësishme që shfrytëzojnë ndryshimet brenda vendit dhe ndryshimet ndërmjet vendeve
- **Kanalet e mundshme**: mospërputhja e kapitalit njerëzor dhe aftësive mund të ndikojë në PP
 - TFP (përmes përmirësimit të inovacionit dhe absorbimit të njohurive)
 - Intensitetit të kapitalit (përplotësimet me kapitalin njerëzor)

Ndikimi i arsimit në produktivitet

- Në përgjithësi, ndikim pozitiv i arsimit në produktivitet
- Sidoqoftë, ky ndikim në produktivitet është më i fortë nëse punëtorët me kualifikim të lartë punojnë në vende pune që kërkojnë kualifikim të lartë
 - ▶ Rëndësia e sigurimit të cilësisë dhe politikave ekonomike



Mospërputhja e aftësive dhe produktivitetit: një marrëdhënie komplekse

Treguesi i mosperputhjes së aftësive	Marrëdhënia e pritshme	Marrëdhënia empirike
Mospërputhja e aftësive amkroekonomike	(+) meqë mospërputhja e lartë e aftësive makroekonomike lidhet me shkallën e ulët të punësimit të personave me kualifikim të ulët dhe produktiviteti i fuqisë punëtore pritet të jetë më i lartë në punësimi është i anshëm ndaj atyre që janë më të kualifikuar	(-) për mostrën e plotë, me siguri për shkak të ndërlidhjes së fuqishme me rritjen ekonomike (+) për BE - 15
Mungesa e aftësive	(-)	(+) me siguri për shkak të ndërlidhjes së fuqishme me rritjen ekonomike
Mbi-kualifikimi (kualifikimi i tepërt)	(+) brenda një kategorie të caktuar të vendeve të punës (-) brenda një kualifikimi të caktuar	(+) brenda një kategorie të caktuar të vendeve të punës (-) brenda një kualifikimi të caktuar
Nën-kualifikimi (kualifikimi i mangët)	(-) brenda një kategorie të caktuar të vendeve të punës (+) brenda një kualifikimi të caktuar	(-) brenda një kategorie të caktuar të vendeve të punës (+) brenda një kualifikimi të caktuar

Burimi: Vandeplas, A. dhe A. Thum-Thysen (2019) “Mospërputhja e aftësive dhe produktiviteti në BE”, DG ECFIN Dokumenti për diskutim Nr. 100. Tabela përmbledh rezultatet bazuar në regresionin e produktivitetit në masat e mospërputhjes së aftësive, kontrollimin për nivelet e aftësive dhe efektet specifike të vendit dhe hendekun e rezultatit (output).

**CILAT AFTËSI NA DUHEN PËR TË
ARDHMEN?**

Tranzicioni i aftësive për një ekonomi digjitale

Nga aftësitë e së kaluarës....
aftësi manuale, të bazuara në rutinë



... në aftësi të së ardhmes

Aftësi
digjitale

TIK dhe
STEM


Aftësitë
themelore

Aftësi jo-
kognitive

Analiza empirike e të dhënave PIAAC


- **Aftësitë themelore:** shkrim-leximi, numërimi, zgjidhja e problemeve
- **Aftësi digjitale:** aftësi themelore kundrejt aftësive komplekse digjitale
- **Treguesi i përbashkët i aftësive kognitive (njohëse)**
- **Aftësi jo-kognitive:**
 - Vetëorganizimi, ndërveprimi dhe komunikimi, menaxhimi dhe mbikëqyrja, gatishmëria për të mësuar dhe kreativiteti, besimi në persona, ndërgjegjshmëria
 - Treguesi i përbashkët i aftësive jo-kognitive (jo-njohëse)
- **Aftësitë fizike**

Ndryshimi i aftësive sipas vendit



- NL, EE performuesit më të mirë në aftësitë **kognitive (njohëse)**
- DK, FI, SE performuesit më të mirë në aftësitë **jo-kognitive (të buta)**
- SI, LT përdoruesit më të shpeshtë të aftësive **fizike**
- Asnjë ndërlidhje e rëndësishme në mes të aftësive njohëse dhe llojeve të tjera të aftësive **në nivel vendi**.

Dallimi në aftësi sipas sektorëve (mesatarja e BE-së)



- **Financa & sigurime, TIK:** aftësi më të larta kognitive dhe jo-kognitive, aftësi më të ulëta fizike
- **Bujqësia, ndërtimi:** përdorimi më i shpeshtë i aftësive fizike
- ▶ **Aftësitë kognitive dhe jo-kognitive të ndërlidhura pozitivisht, negativisht me aftësitë fizike**

Sektorët: A: Bujqësia; B-E: Industria; F: Ndërtimtaria; G-I: Tregtia, ushqimi dhe akomodimi; J: TIK; K: Financat dhe Sigurimet; L: Prona e paluajtshme; M_N: Shërbime profesionale dhe afariste; O-Q: Sektori publik; R-U: Artet, argëtimi etj.

Aftësitë jo-kognitive kanë rëndësi për produktivitetin

Aftësia	Korrelacioni me produktivitet
Aftësitë fizike	(-) ^{***}
Njohja e numrave	(+) ^{***}
Shkrim-leximi	(+) ^{***}
Zgjidhja e problemeve	(+) ^{***}
Aftësitë e TIK - komplekse	(+) ^{***}
Aftësitë e TIK – të thjeshta	(+) ^{***}
Aftësitë njohëse - të përbashkëta	(+) ^{***}
Gatishmëria për të mësuar dhe të menduarit kreativ	(+) ^{***}
Ndërgjegjshmëria	(+) ^{***}
Besimi në njerëz	(+) ^{***}
Ndërveprimi dhe komunikimi	(+) ^{***}
Menaxhimi dhe mbikëqyrja	(+) ^{***}
Vetorganizimi	0
Aftësitë jo-kognitive - të përbashkëta	(+) ^{***}

Burimi: Llogaritje të bëra vet bazuar në të dhënat e PIAAC dhe ECKLEMS të morandumi, thirrje të thyesen dhe vandeprës (2020), "Përballja me transformimin digjital: a janë të mjaftueshme aftësitë digjitale?", DP ECFIN Dokumenti për politika ekonomike

PËRFUNDIMI DHE IMPLIKIMET NË POLITIKA

Përfundime dhe implikimet në politika


- Investimi në kapitalin njerëzor është kyç në përvetësimin e teknologjisë, në produktivitet dhe rritje ekonomike ►►► **nuk ka rëndësi vetëm sasia e shpenzimeve, por edhe efikasiteti i shpenzimeve për të synuar sasinë, cilësinë dhe përfshirjen**
- Mospërputhja më e ultë e aftësive shoqërohet me performancë të mirë ekonomike ►►► **rrit ofertën me fuqisë punëtore të kualifikuar** (p.sh. investimi në ngritje të aftësive dhe riaftësim) **dhe kërkesës** (p.sh. promovimi i krijimit të vendeve të punës në sektorë që kërkojnë kualifikim më të lartë)
- Ndërtimi i “aftësive për ekonominë digjitale” për të nxitur produktivitetin kërkon një qasje të shumanshme ►►► **rrit aftësitë digjitale dhe kognitive, por edhe aftësitë jo-kognitive siç janë vetë-organizimi ose puna ekipore** (për shembull përmes hartimit të programit)

Levat e politikave

- ▶▶▶ Çfarë mund të bëjnë qeveritë e vendeve?
 - Reforma në sistemin e arsimit, trajnimit dhe aftësisimit (përfshirë mësimin për të rriturit) dhe politika më të gjera ekonomike (mjedisi i biznesit, administrata publike, K & ZH).
- ▶▶▶ Çfarë mund të bëjë BE-ja?
 - **Në BE:**
 - Udhëzime të gjera të politikave përmes iniciativave si Zona Evropiane e Arsimit, Agjenda Evropiane e Aftësive, Plani i Veprimit për Arsimin Digjital, ...
 - Udhëzime për politikat specifike për një vend përmes Semestrit Evropian.
 - Mbështetje për reformat dhe investimet përmes NextGenerationEU (Instrumenti i Rimëkëmbjes dhe Qëndrueshmërisë dhe Instrumenti i Mbështetjes Teknike) dhe instrumenteve të tjera në MFF 2021-27: ESF, Erasmus, ERDF, EGF, Fondi i Tranzicionit të Drejtë, REACT-EU, rezerva e Rregullimit të Brexit,
 - **Në vendet [kandidate] për anëtarësim:**
 - Instrumenti i ndihmës së para-anëtarësimit, Asistenca teknike dhe instrumenti i shkëmbimit të informacionit (TAIEX).

Referencat

- Kiss, A., & Vandeplas, A. (2015). Matja e mospërputhjes së kualifikimeve (aftësive) Shënimi analitik në internet 7/2015 DG EMPL,
- **Duke u bazuar në punën e mëparshme të Komisionit:** Arpaia, A., Kiss, A., & Turrini, A. (2014). A është papunësia strukturore apo ciklike? Karakteristikat kryesore të përputhjes së vendeve të punës në BE pas krizës. Dokumenti i politikave të IZA-s Nr. 91.
- Aktivitetet përcjellëse:
 - Vandeplas, A., & Thum-Thysen, A. (2019). Mospërputhja e aftësive dhe produktivitetit në BE. Dokumenti për diskutim për Ekonominë Evropiane 100
 - Morandini, MC, Thum-Thysen, A., & Vandeplas, A. (2020). Përballja me transformimin digjital: A janë të mjaftueshme aftësitë digjitale? Dokumenti informues ekonomik i Bashkimit European 054



Faleminderit



© Bashkimi Evropian 2020

Nëse nuk theksohet ndryshe, ripërdorimi i këtij prezantimi është i autorizuar në bazë të licencës [CC BY 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/). Për çdo përdorim ose riprodhim të elementeve që nuk janë në pronësi të BE-së, duhet të kërkohet leja drejtpërdrejt nga mbajtësit përkatës i të drejtës.

Sllajdi xx: [elementi në fjalë](#), burimi: [p.sh Fotolia.com](#); Sllajdi xx: [elementi në fjalë](#), burimi: [p.sh iStock.com](#)






European
Commission


Sllajde shtesë

Mospërputhja e aftësive makro-ekonomike




- **Trend në rënie** në Maqedoninë e Veriut
- **Trend në rritje** në Turqi
- **Serbia:** rënie deri në 2016 dhe stabilizim që nga ajo kohë
- **Mali i Zi:** rënie deri në 2018, ngritje që atëherë

Mungesat e aftësive



Ndryshimi i niveleve të aftësive në shkallë vendi, sektori i industrisë (NACE B-E)



- Sektori i industrisë kërkon më shumë njohuri në NL, DK, SK sesa në CY, EL dhe FR.
- Aftësitë fizike më të rëndësishme në LT, SI, PL sesa në FI, BE, FR.
- Rezultati i specializimit industrial dhe organizimit të proceseve të prodhimit (ndikuar nga kushtet dhe politikat ekonomike)